



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 6 , datë 18.10.2013

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT**

Në mbështetje të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, VKM-së nr. 1190, datë 13.11.2009 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit”, VKM-së nr 887, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit”, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar të Territorit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E K.K.T

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT

Eggeni



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË
TERRITORIT**

Adelina Greca

